

KADARE'S NEWLY-FORMED WORDS WITH THE SUFFIX – SHËM FJALËT E KRIJUARA NGA KADAREJA ME PRAPASHTESËN – SHËM

LULJETA ADILI-ÇELIKU; JEHONA RUSHIDI-REXHEPI
Universiteti i Europës Juglindore, Tetovë, Maqedoni
l.adili@seeu.edu.mk

AKTET V, 4: 687-691, 2012

PERMBLEDHJE

Të studiosh gjuhën e një shkrimtari do të thotë t'i dalësh krah punës së tij letrare dhe gjuhës që ai përdor. Meqë gjuha është materie e gjallë, ajo mund të lëndohet dhe dëmtohet. Kadareja si vizionar që është e ndien këtë rrezik, prandaj iu përvesh misionit të ruajtjes së gjuhës shqipe por edhe pasurimit të saj me fjalë të reja. Duke u nisur si nga nevojat leksikore ashtu edhe nga nevojat stilistike dhe estetike, ai krijoi fjalë të reja gati me gjithë parashtesat dhe prapashtesat e gjuhës shqipe, gjithmonë duke i bazuar prurjet e tij në rregullat e brendshme të fjalëformimit të shqipes, pa dëmtuar strukturën morfologjike. Në këtë punim i mësohet krijimit të fjalëve me prapashtesën – shëm. Problematika e rrahur në këtë artikull sjell ndihmesë të çmueshme në studimin e fjalësisë të Ismail Kadaresë dhe në pasurimin e fjalorit të gjuhës shqipe.

Fjale kyçe: Kadareja, fjalët e reja, fjalëformimi, prapashtesa -shëm.

SUMMARY

If a scholar studies the language that a particular writer uses, that implies that the same that scholar endorses that writer's work. Language itself is alive and just like anything that is alive, it can be subject to injuries and damages. Ismail Kadare is a visionary who senses the danger that the language may encounter. That is the reason why he "goes" on a mission to protect and enrich the Albanian language with newly-formed words. Using almost each and every one of the suffixes and prefixes of the language while applying to the internal word-forming rules that the Albanian language dictates, Ismail Kadare has created a large amount of words that carry an immense lexical and stylistic value, without being morphologically incorrect. In this paper we study Ismail Kadare's newly-formed words using the suffix – shëm, thus offering our contribution to the studying of Ismail Kadare's newly-formed vocabulary.

Key words: Kadare, new words, word formation, suffix –shëm

Hyrja

Shqipja ka një traditë të gjatë të pasurimit të gjuhës nga ana e shkrimtarëve. Në këtë kontekst, është e pashmangshme përmendja e rilindësve si lëvrues më të mëdhenj të gjuhës. Megjithatë, nëse për një çast lëmë anash traditën e Rilindjes dhe i hedhim një sy letërsisë bashkëkohore, ai që nxjerr krye mbi të tjerët me prurjet dhe kujdesin e jashtëzakonshëm është Ismail Kadareja. Studiuesit që kryesisht janë marrë me studimin e fjalës së Ismail Kadaresë dhe i kanë mbledhur shumicën e fjalëve të krijuar ose të ringjallur nga

ai janë Tefik Çausi dhe Natasha Sotiri. Ky punim, në të cilin janë mbledhur vetëm fjalët me prapashtesën –shëm, duke u bazuar vetëm në tri vepra të tij „Lulet e ftohta të marsit, Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazrekut dhe Ura me tri harqe, tenton të plotësojë studimet e deritashme për mbledhjen e fjalëve të këtij shkrimtari.

Ka kohë që shkrimtari ynë Ismail Kadare i ka vënë në punë si kritikët letrarë, ashtu edhe studiuesit e gjuhës shqipe. Në këso kohësh të turbullta kur gjuha sulmohet nga gjuhët globale, kur zhvillimi teknik dhe teknologjik është i vrullshëm dhe

marramendës, Kadareja, me largpamësinë e shkrimtarit të madh, kërkon dhe nxjerr fjalë të lëna në harresë, fjalë të përdorura në krahina të largëta, fjalë që kishin dhënë shpirt e që ai i rikthen në jetë. Këto dhe karakteristika të tjera të krijmtarisë së tij hapin shumë çështje për t'u shtruar.

Duke u nisur nga moria e krijimeve gjuhësore dialektore, në këtë punim do të veçohen formimet me prapashtesën *-shëm*. Kjo prapashtesë, që është e gegërishtes veriore, tërheq vëmendjen jo vetëm për nga denduria, por edhe për nga mënyra e formimit dhe e evolucionit të saj semantik.

1. Teknika e kombinimit të elementeve konstituive të neologjizmat e Kadaresë

Duke u bazuar në studimet e Jani Thomait në lidhje me mënyrën e krijimit të fjalëve të reja, konkretisht njësitë leksikore të cilat bashkohen dhe si rezultat i tyre fitohen neologjizma, në këtë punim është vënë re se Kadareja përdor po të njëjtat elemente përbërëse të gjuhës shqipe, por në disa raste hasen krijime kontekstuale. Më poshtë janë dhënë mjetet me të cilat krijon Kadare neologjizma dhe shembuj konkretë:

1. *Tema (ose rrënja) fjalëformuese, e cila mbart kuptimin leksikor ose përbërësin themelorë të tij. Thelbi i kuptimit që mbart ajo ose përbërësit themelorë të saj ruhen e hyjnë në kuptimin leksikor të fjalës që krijohet, marrin pjesë në ngjizjen e saj* (Thomai , faqe 119) p.sh. fjala *i hapësirshëm* ka si temë fjalën *hapësirë*, ndërsa Kadareja ka krijuar një fjalë të re duke përdorur prapashtesën *-shëm* dhe duke e nyjzuar atë. Shihet se një pjesë të kuptimit e mbart tema, megjithatë edhe prapashtesa fjalëformuese në këtë rast, mbart pjesën tjetër të kuptimit, *hyjnueshëm/ me i,e* –(që është hyjnor; i perëndishëm; qiellor; që është i shenjtë. (Natasha faqe 449) ,/ Ura ,faqe 73/).

2. *Mjeti fjalëformues (ndajshitesat), i cili i sjell modifikime të rëndësishme temës semantike (kuptimit të temës fjalëformuese). Ndajshitesa sjell ndryshime kuptimore, ndryshime të kategorisë leksiko-gramatikore (të pjesës së ligjëratës), të elementeve mbishtrësore etj. (*

Thomai, faqe 119) P.sh. fjala *mundimshëm* , prej fjalës *mundim* me ndihmën e prapashtesës – *shëm* është krijuar ndajfolja *mundimshëm*(me mundime, duke u munduar shumë; me vuajtje,/ Ura faqe 73/110, / Jeta e Lulit, faqe 22/).

Gjatë krijimit të fjalëve të reja ndodhin lëvizje në përmbajtjet fjalëve:

a) *Mund të ndryshojë kuptimi leksiko-gramatikor* (Thomai, faqe 120); pra kuptimi kategoria; p.sh nga **folja ngut** (shpejtoj, vrapoj), Kadareja ka krijuar **mbiemrin ngutshme/ ëm- të** –(ngutas, me ngut, ngutthi./ Lulet , faqe 129/);

b) *Mund të ndryshojë ndonjë element semantik* (Thomai, faqe 120), të karakterit emocionues, stilistik, etj. Edhe këto lëvizje i sjellin zakonisht ndajshitesat; p.sh. nga folja *dredh* është formuar ndajfolja *dridhsh/ëm* (me dridhje, shoqëruar me dridhje nga të ftohtët apo nga tronditja, duke u dridhur, me emocion, përmallshëm, /Jeta e Lulit, faqe 72).

c) *Mund të ndryshojnë elemente të veçanta të përmbajtjes, që e bëjnë atë shumëvlerëshe nga ana e kuptimit kategorial; gjatë formimit të fjalëve përftohet një vlerë e re , që është karakteristike për pjesë tjera të ligjëratës*(Thomai, faqe 120), nga folja *gëzue*, është fituar ndajfoljen *gëzueshëm* (me gëzim, në mënyrë të gëzueshme; hareshëm; me ëmbëlsi;/ Lulet, faqe 14/).

Kategoria e mbiemrave të nyjshëm më *-shëm* në gjuhën shqipe është shumë e pasur. Por ajo që tërheq vëmendjen në mbiemrat e krijuar prej Kadaresë me këtë prapashtesë, është se në shumë prej tyre tema është togfjalësh i njëfjalëzuar. Të tillë janë mbiemrat: *dytrajtshëm/ me (i,e), kryehershëm/ me- (i,e), fundbotshëm/ me (i,e) etj* . Shkrimtari përdor si temë të tyre togfjalësh, të cilin e njëfjalëzon, duke krijuar kështu një emër të ri, dhe më pas e përdor këtë si temë për të krijuar një mbiemër, duke e nyjzuar dhe prapashtesuar njëherësh. Kështu nga togu *fundi i botës*, ai ka krijuar emrin *fundbota* dhe prej këtij mbiemrin *i fundbotshëm*.

Gjithashtu, Kadareja përdor shumë edhe ndajfolje me këtë prapashtesë, të cilat janë veçori e gegërishtes veriore. Ai fut në përdorim një numër të madh ndajfoljesh më-*shëm*, të cilat nuk

pasqyrohen në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe dhe që ai ose i merr të gatshme nga gegërishtja ose i krijon vetë sipas modelit të saj, duke e rritur sasinë e tyre. Të tilla janë: *këtejshëm*, *kobshme*, *kryehershme*, *kujdesshëm*, etj.

2. Neologjizmat me prapashtesën –shëm që dalin si mbiemra

Siç thamë, me këtë prapashtesë janë formuar prej emrash, foljesh e ndajfoljesh mbiemra që tregojnë një cilësi të rrjedhur nga të pajisurit me një gjë ose me një veti. P.sh:

dytrajtshëm/ me i,e (që ka ose shfaqet me dy trajta që është dy llojesh (Natasha faqe 249) ,/ Jeta e Lulit, faqe 224/); *fundbotshëm/ me i,e* (i gjëmshëm; shumë i hidhur (Natasha faqe 328), / Lulet, faqe 63/); *gjithgjendshëm/ me i,e* (që ndodhet a takohet kudo; i kudogjendur (Natasha faqe 385), /Ura, faqe 37/); *habitshme/ të* (që është aq i pazakontë sa të habit(Natasha 402), /Lulet, faqe 126/); *hyjnueshëm/ me i,e* (që është hyjnor; i perëndishëm; qiellor; që është i shenjtë. (Natasha faqe 449) ,/ Ura ,faqe 73/); *kryehershëm/ me- i,e* (që është i pari, që është prej në fillim;/ Lulet, faqe 63/); *kotsëkotshëm/ me- i,e* (që nuk ka asnjë vlerë; që është pa asnjë meritë /Jeta e Lulit, faqe 148/); *mundueshëm/me- të* (që janë munduar shumë, nuk ka qenë e lehtë me sakrificë të madhe. /Lulet , faqe 122/); *nënujshme/ ëm- i,e* (që gjendet nën ujë; nuk i takon tokës /Lulet, faqe 137/); *ngutshme/ ëm- të* –(që shpejtojnë shumë, që nguten; / Lulet , faqe 129/); *ngeshëm/ me i,e* –(/Ura, faqe 121/); *papengueshëm/ me i,e* (që nuk mund të ndalet ose pengohet; që nuk të pengon ose te ndal. /Ura, faqe 128/); *papërfytyrshëm/ me i,e* (që nuk mund të përfytyrohet; i tillë që nuk mund të perceptohet nga truri /Lulet, faqe 95/); *pavjedhshëm/ me i,e* (që nuk mund të vidhet nga askush asnjëherë /Lulet, faqe 95/); *rrokshme/ ëm –të* (që mund të kapet, të rrokët; që është lehtë për tu kapur, rrokur. /Lulet ,faqe 129/); *sipërfaqshme/ ëm i,e* (që është sipërfaqësor, nuk është i thellë; që shihet lehtë pa mos u munduar /Ura, faqe 100/); *turrshëm/ me i,e* (që është i shpejtë, që vrapon, që shpejton me turr; që shkon me të katra vrap;

pa u menduar gjatë, pa u hamendur shumë, // Ura , faqe 48/); *ujshëm/ me i,e* (që është prej uji, që përbëhet prej uji/U,ra faqe 71/); *vështirshëm/ me i,e* (që është shumë i vështirë; që nuk është i lehtë; që nuk mund të /Lulet , faqe 85/); *vdekshëm/ me i,e* (që është i vdekshëm, nuk është i përjetshëm; që nuk mund të jete gjithë jetës; që mund të prishet./Lulet , faqe 58/); *zishme/ ëm i,e* (që është në zi , që nuk është i bardhë; që është duke mbajtur zi./Ura, faqe 139/).

3. Neologjizmat me prapashtesën –shëm që dalin si ndajfolje

andeshëm –(duke mos i takuar kësaj ane duke qenë i anesë tjetër ; duke mos qenë i yni; duke mos i takon kësaj jete /Ura,faqe 71/); *dantealigershëm* – (*si* personazhet e ferrit të Dante Aligerit që rrokullisen në të me shpejtesi (Natasha, faqe 195), / Lulet, faqe 101/); *dridhshëm* (me dridhje, shoqëruar me dridhje nga të ftohtët apo nga tronditja, duke u dridhur; me emocion; përmallshëm, /Jeta e Lulit, faqe 72/); *furishëm-* (*me* zemërim të papërmbytur; me tërbim (Natasha faqe 331), /Jeta e Lulit, faqe 84/); *gëzueshëm* (me gëzim, në mënyrë të gëzueshme; hareshëm; me ëmbëlsi;/ Lulet, faqe 14/); *habitshëm* (me habi, me një ndjenjë a me një pamje që shpreh habi; duke qenë i hutuar; me një ndjenjë a me një pamje që shpreh ose tregon habi; me habi (Natasha 402),/Ura, faqe 70/); *hareshëm-* (me shume gezim/ Jeta e Lulit , faqe 14/); *hovshëm-*(me vrull e menjihërë (Natasha faqe 438 / Ura, faqe 110/); *hutueshëm-*(me ndrojtje (Natasha faqe 448) ,/ Lulet, faqe 16/); *këtejshëm-* (duke i takuar kësaj ane e jo anesë tjetër ; duke qenë i yni; duke i takuar kësaj jete./Ura, faqe 71/); *kobshme-* (duke ndjellë fatkeqësi; / Ura ,faqe 75/); *kryehershme-* (duke qenë i pari, prej në fillim; /Lulet, faqe 112/); *kujdesshëm-* (duke patur kujdes;duke u kujdesur për çdo detal, duke mos të ikur asgjë. /Lulet, faqe 35/); *lodrueshëm*(duke luajtur a duke lodruar, duke u hedhur e kërcyer me qejf,/ Jeta e Lulit, faqe 244/); *mallëngjyeshëm* (me mallëngjim; me dhembshuri , /Jeta e Lulit, faqe 94/); *mendueshëm-*(duke u menduar; duke u humbur në mendime / Ura, faqe 56/).

Ura me tri harqe	Lulet e ftohta të marsit	Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazrekut
i gjithgjendshëm	i,e krzehershëm	i,e gjithunjshëm
i turrshëm	i,e fundbotshëm	i,e kotsëkotshtëm
i ujshëm	i,e vështirshëm	i,e dytrajtshëm
i hyjnueshëm	i,e pavjedhshëm	
e sipërfaqshme	i,e papërfytyrshëm	
i ngeshëm	të mundueshëm	
i papengueshëm	të habitshme	
e zishme	të rrokshme	
	të ngutshme	
	i,e nënujshme	
	i,e vdekshëm	

Tabela 1. Neologjizmat e Kadaresë që dalin si mbiemra me prapashtesën –shëm

Ura me tri harqe	Lulet e ftohta të marsit	Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazrekut
skëterrshëm	gëzueshëm	ngadalshëm
vullshëm	trëndafilshëm	haraeshëm
mendueshëm	hutueshëm	mundinshëm
përbuzshëm	zishëm	rrezikshëm
habitshëm	Përvajshëm	përtueshëm
këtejshëm	kujdesshëm	njëtrajtshëm
andejshëm	vruleshëm	dridhshëm
mundimshëm	vdekatar/e	rrëmbyeshëm
kobshme	vajtueshëm	furishëm
turrshëm	marramendshëm	shqetsueshëm
hovshëm	dantealigershëm	mallëngjyeshëm
potershëm	ngutshëm	ngatrueshëm
tronditshëm	krzehershme	vëmendshëm
	verbueshëm	rrokshëm
	mekshëm	mekshëm
		lodrueshëm

Tabela 2. Neologjizmat e Kadaresë që dalin si ndajfolje me prapashtesën –shëm

Mbiemra	Ndajfolje	Vepra
11	15	Lulet e ftohta të marsit
3	16	Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazrekut
8	13	Ura me tri harqe
22	44	Gjithsej

Tabela 3. Paraqitja numerike e mbiemrave dhe ndajfoljeve neologjizma të Kadaresë në të trija veprat objekt studimi të këtij punimi.

marramendshëm (duke shkaktuar marramendje; me shpejtësi të madhe aq sa të shkaktojë marramendje; duke shkaktuar huti apo trandje, / Lulet, faqe 101/); *mekshëm* (dobët, duke u dobësuar; me mpakje,/ Jeta faqe 173/,/ Lulet , faqe147); *mundimshëm* (me mundime, duke u munduar shumë; me vuajtje,/ Ura faqe 73/110, / Jeta e Lulit, faqe 22/); *ngadalshëm* (me ngadalësi, në mënyrë të ngadalshme; duke mos u ngutur, shtruar,/ Jeta e Lulit, faqe 12/); *ngatërrueshëm* (në mënyrë të ngatërruar, duke u ngatërruar; në mënyrë të paqartë./Jeta e Lulit, faqe 126/); *ngutshëm* (ngutas, me ngut, ngutthi,/ Lulet, faqe 101/); *njëtrajtshëm*- (duke qenë i një trajte; duke mos ndryshuar. /Jeta e Lulit, faqe 63); *përbuzshëm* (me përbuzje, duke qenë përbuzës a mospërfillës,/Ura ,faqe 67/); *përtueshëm* (me përtim, gjithë përtim; me ngathtësi, ngadalë e duke përtuar,/ Jeta e Lulit,faqe 37/); *përvajshëm*- (si në vaj /Lulet, faqe 35/). *potershëm*- (me zhurmë të madhe, me ulërimë; duke qenë i zhurmshëm pa nevojë. /Ura ,faqe 121/). *rrokshëm*- (i kapshëm; që mund te kapet, të preket /Jeta e Lulit, faqe 165/). *skëtërrshëm* (si në skëtërrë: në terr dhe gjithë frikë; frikshëm, në mënyrë të tmerrshme,/Ura ,faqe 17/); *shqetësueshëm* (me shqetësim, gjithë shqetësim, në mënyrë të tillë që shpreh shqetësim; duke shpërndarë shqetësim, /Jeta e Lulit,faqe 94/); *trëndafilshëm* (gjithë gëzim e lumturi, gjithë shpresë, /Lulet faqe 15/); *turrshëm* (me turr, me vrap, me të shpejtë, me të katra; pa u menduar gjatë, pa u hamendur shumë,/Ura, faqe 101/); *vajtueshëm* (si në vaj, me vaj, duke lëshuar një zë që i ngjan vajit. / Lulet faqe 99/); *verbueshëm*- (në mënyrë të atillë që të bën të mos shohësh qartë, duke të vlarë sytë, /Lulet, faqe 120/); *vrullshëm* - (me vrull të madh /Lulet, faqe 57/, /Ura ,faqe 33/); *vëmendshëm*- (me vëmendje, me përqendrim të plotë. /Jeta e Lulit, faqe 139/); *zishëm* – (duke mbajtur zi, duke

qenë plotësisht në zi, në zi të madhe. /Lulet, faqe 22/).**Përfundim**

Ky studim u orvat të shtrojë një problematikë jo shumë të trajtuar nga studiuesit e fjalës shqipe. Fjalët e krijuara me prapashtesën –*shëm* janë shumë domethënëse si për veprat e autorit, ashtu edhe për gjuhën shqipe, sepse shkrintari fut edhe një element të dialektit verior ne veprën e tij,qëllimisht, duke iu kundërvënë thënieve, lëvizjeve dhe zërave që brohorisnin se gjuha letrare u krijua nga dialekti jugor në kurriz të gegërishtes. Përveç kësaj, ai gjykon se fjalët e dialektit të veriut janë më ngjyrëdhënëse, ose me të fuqishme nëse përdoren me po atë theks, ose me po ato veti fonetiko-gramatikore siç janë në dialektin e tyre. Punimi është ndarë në tri pjesë. Në pjesën e parë u paraqitën elementet të cilat i përdor shkrintari gjatë krijimit të fjalëve të reja. Pjesa e dyte është një fjalorth në të cilin janë sqaruar fjalët e krijuara dhe në fund, punimi ndiqet nga tabelat, në të cilat janë dhënë ndarje sipas kategorisë leksiko-gramatikore si dhe përfaqësimi numerik i neologjizmave të gjetur në veprat e lartpërmendura.

Bibliografia

- KADARE, Ismail. *Lulet e ftohta të marsit*. Tiranë: Onufri, 2000
- KADARE, Ismail. *Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazrekut*. Tiranë: Onufri, 2002
- KADARE, Ismail. *Ura me tri harqe*. Tiranë: Onufri, 2004
- ÇAUSHI, Tefik dhe Shkurtaç Gjovalin. *Kadareja dhe fjala shqipe*. Tiranë: Albas, 2004
- SOTIRI, Natasha. *Fjala shqipe dhe gjuha e Ismail Kadaresë*. Tiranë: Tiranë: Medaur, 2007
- THOMAI, Jani. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë: Botimet Dudaj, 2005. .